- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvministrat, Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët e Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtij ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Dokumentat standarte të tenderit

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË
Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit të konsulentit³

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Në bazë të parashikimeve të neneve 28 dhe 37 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të Konsulentit “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM Konsulentin “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo konsulenti tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

3. Nuk ndodhem në kushtet e konfliktit të interesit, **me asnjë** nga anëtarët e stafit të autoritetit kontraktor, drejtpërdrejtë ose jo, i përfshirë në ndonjë pjesë të përgatitjes së kushteve të kontratës dhe/ose në procesin e përzgjedhjes për këtë kontratë dhe/ose për mbikëqyrjen e kësaj kontrate.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

³ Kjo deklaratë duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të stafit të konsulentit dhe do të jetë pjesë e dokumentave të ofertës së konsulentit.

Shtojca 10

[Shtojce per tu plotesuar nga Autoriteti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 11.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të dorëzojë vetdeklarimet, sipas kësaj Shtojce.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet te dorezohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar, sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht⁴;
- b. Prokura e posaçme.

⁴ Në këtë marrëveshje nuk duhet të përcaktohet përqindja e shërbimeve të secilit anëtar, por fushat/ekspertizat e marra përsipër për tu realizuar.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurimin e Ofertës (nese eshte e zbatueshme) sipas Shtojcës 6;*
- b Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 8;*
- c. Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit të konsulentit, sipas Shtojcës 9;*
- ç. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*
- d. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojces 11/1:*

2. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1.Kapaciteti Ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Ofertuesi duhet të paraqese kopje të çertifikuar të bilanceve te tre viteve të fundit ushtrimore (2017,2018,2019), të paraqitur në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave, të konfirmuar nga ky autoritet

2.2.2. Ofertuesi duhet të paraqese kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2017, 2018, 2019) lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e se ciles duhet te jete jo me e vogel se 60 % e fondit limit dhe bilanci te mos jete me humbje.

2.2.3. Ofertuesi duhet të paraqese vërtetim lëshuar nga institucionet përkatëse për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2019,2020 ku subjekti është i regjistruar.

2.3. Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Oferuesi duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

2.3.1. Shërbime të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, të aktivitetit të operatorit ekonomik, në vlerë jo me te vogel se 40% e fondit limit të vënë në dispozicion.

Per te vertetuar pervojen e meparshme duhet te paraqiten dokumentat si me poshte:

- a. Kur kontratat jane te realizuara me institucione shteterore ofertuesi duhet te paraqese kontraten e lidhur me Institucionin te shoqeruar me vertetimet nga institucioni me te cilin jane

nenshkruar keto kontrata mbi realizimin me sukses te tyre, si dhe faturat tatimore te shitjes ku të shënohet data, vlera, dhe shërbimet e realizuara.

b. Kur kontratat janë te realizuara me ente private ofertuesi duhet te paraqese faturat tatimore te shitjes (ku te shprehen qarte datat, shumat, dhe shërbimet e realizuara, te firmosura dhe te vulosura nga te dy palet).

2.3.2. Liçensa profesionale lidhur me shërbimet objekt i kontratës:

Operatori ekonomik ose bashkimi i Operatoreve Ekonomike duhet te zoteroje licencat e neposhtme profesionale ne projektim ku të përfshihen kategorite:

- 1/c Plane te detajuar vendore
- 2/a: Projektim arkitektonik për objekte civile - industriale –turistike-vepra arti në infrastrukturë.
- 2/d: Projektim pejsazhi, sistemi siperfaqe te gjelberta, lulishte e parqe
- 3/a: Objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.
- 3/d: Vleresim i kapacitetit mbajtës dhe perforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme , murature dhe metalike.
- 4/a: Instalime hidrosanitare.
- 4/b: Instalime termoteknik – ventilimi - kondicionimi.
- 4/c: Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.
- 4/f: Projektim të sistemeve kundra zjarrit.
- 5/b: Furnizim me uje – kolektore shkarkimi
- 5/c: Projektim ujsjelles kanalizime Urbane-rurale
- 5/d: Projektim vepra ujitje kullim impiante vadites diga te vogela
- 5/f: Projektim vepra hidrike , galeri e tunele hidraulike marrje uji shkarkim- shkarkues te ujrave te tepert vepra e marrjes se ujit nga rezervuaret , veprat e marrjes se ujit nga lumenjte dhe marrja e ujit me puse
- 5/h: Projektim vepra hidrike – kulla ekuilibri - porte – pontile
- 6a: Projektim rruge lokale rruge urbane dytesore dhe rruge inter urbane
- 6/b: Projektim rruge urbane kryesore
- 8/a: Bazamente gjeodezike-rilevime në të gjitha shkallët
- 8/b: Rilevime inxhinierike kadastrale
- 8/d: Bazamente gjeodezik
- 9/d: Studim / Vleresim gjeologo inxhinierik i trojeve te buta dhe shpateve me qendrueshmeri te ulet
- 9/e: Studime e projektme hidrologjike
- 10/e: Kabina elektrike të rrjetit shpërndarës – linja te tensionit te ulet – te mesem.
- 11/a: Sinjalistike ne rruge lokale, rruge urbane dytesore dhe rruge interurbane dytesore.
- 13/ Studim e projektim tendertimit dhe mbylljes se vendeponitimeve te mbetjeve te ngurta(Urbane)

Kërkesat formale-ligjore për Kandidatët e Huaj pjesëmarrës.

-Kandidati/Ofertuesi i huaj pjesëmarrës duhet detyrimisht të ekuivalente (njesoje), licencën profesionale që disponon, të leshuar nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit. Operatorët e huaj ekonomik, duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqipe (si gjuhë e ofertës), të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe të jenë të certifikuara “Apostille”. Për vendet që nuk kanë ratifikuar Konventën e Hagës, datë 5 tetor 1961, “për heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumenteve zyrtare të huaja”, duhet të bëhen legalizimet në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës. (Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues).

Ne lidhje me vlefshmerinë e licencave ekzistuese dhe pershtatjen e kategorive me pershkrimet përkatëse, ofertuesit të mbajnë parasysh VKM-ne nr.759 date 12.11.2014 ”Per licencimin profesional te individeve dhe subjekteve juridike qe do te ushtrojne veprimtari ne fushen e studimit e te projektimit ne ndertim dhe mbikqyrjes e kolaudit te punimeve te zbatimit ne ndertim”. Shoqëritë e huaja, në lidhje me ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës, të zbatojnë legjislacionin shqiptar në fuqi: ”Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhenies së Licencave profesionale të zbatimit. Klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojne veprimtari ndertimi”, e miratuar me VKM nr.42, date 16.01.2008.Urdheri i MPPTT nr.116, date 31.07.2008

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të vertetojë me Dëshmi për fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit: Numri mesatar i punonjësve të siguruar duhet të jetë jo më pak se 15 (Pesëmbëdhjetë) punonjës për periudhën Shkurt 2020 – Dhjetor 2020.

Për këto kriter, operatori ekonomik duhet të paraqesë detyrimisht :

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën Janar 2020 – Tetor 2020
2. Listëpagesat përkatëse të konfirmuara nga Drejtoria e Tatimeve.

2.3.4 Operatori ekonomik të ketë në stafin e tij

2.3.4.1) Staf kryesor i cili të figurojnë në licencën e shoqërisë me pozicionin drejtues teknik:

- a) Arkitekt
- b) Inxhinier Ndertimi
- c) Inxhinier Mekanik
- d) Inxhinier Elektrik
- e) Inxhinier Gjeodet (Topograf)
- f) Inxhinier Hidroteknik
- g) Ekspert të vleresimit në mjedis
- h) Inxhinier gjeolog/hidrolog

2.3.4.2) Staf mbështetës

- i) Inxhinier Hidroteknik

- j) Inxhinier Gjeodet (Topograf)
- k) Inxhinier IT
- l) Elektrik
- m) Agronom

Specialistët e mesipërm të jene me experience mbi 5 vjecare dhe të paraqitet Diploma e Shkolles se Larte/License/Çertifikaten e ushtrimit te profesionit sipas legjislacionit, kontraten e punes dhe te figuroje ne Formularet E-Sig 025/a per periudhen e kerkuar

Gjithashtu ky staf duhet të jetë në listpagesat e shoqërisë për periudhen korrik 2020 –Dhjetor 2020 për cdo muaj.

2.3.4.3) Operatori ekonomik duhet te kete ne stafin personel te çertifikuar:

- me certifikate per Ndhimen e Pare e cila te jete e leshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqeri te akredituara me eksperience pune jo me pak se 3 vjet.
- me certifikate si Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune me eksperience pune jo me pak se 3 vjet.
- me certifikate per ushtrimin e profesionit “Ekspert zjarrfikes privat” ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin me objekt: Studimi dhe pergatitja e projekteve mbi masat e mbrojtjes nga zjarri te ndertesave te cdo lloji.

2.3.5. Operatori ekonomik, për realizimin e kontratës, duhet te disponoje 1 (nje) mjet transporti të specialistëve. Per te veretuar kete duhet te paraqese deshmi per mjetet dhe pajisjet teknike qe ka ne dispozicion apo që mund t’i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik.

Për të dëshmuar këtë kriter, duhet të paraqiten dokumentat e mëposhteme:

- a) Për mjetet ne pronesi qe shenohen ne rregjistrat publike, duhet te paraqiten dokumentat qe vertetojne rregjistrimin e mjetit si: Leje Qarkullimi, Siguracionin e mjetit dhe Çertifikatën e Kontrollit teknik.
- b) Për mjete e marra me qera dokumentave te mesiperm ti bashkëlidhen Kontrata perkatese te qerases / leasing / huaperdorjes, në emër të objektit, të jenë të lidhura para noterit dhe afati i të cilave të perfshijë periudhën e realizimit të kontratës së shërbimit..

2.3.6 Kandidati/operatori ekonomik ofertues, duhet te disponoje, ne pronesi ose me qera, aparat GPS per punime topografike, 1 (një) cope i cili te jete i certifikuar.

Per kete te paraqitet dokumenti qe verteton pronesine (Fatura Tatimore shitblerje), ose Kontrata Noteriale e Qerases, me objekt prokurimi, se bashku me dokumentin qe verteton pronesine (origjinal ose fotokopje e noterizuar).

2.3.7. Operatori Ekonomik duhet te vërtetojë se është i pajisur me Certifikatat që vërtetojnë plotësimin e kapaciteteve të cilësisë të organizimit dhe zbatimit të standartave në aktivitetin e vet në lidhje me fushat meposhtme:

-ISO 9001:2015 (Për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë)

-ISO 14001:2004 (Për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit)

Dokumentat standarte të tenderit

- ISO OHSAS 18001-2007 (Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë)*
- BS ISO 39001 : 2012 (Për sigurinë në trafikun rrugor)*
- ISO 50001:2011 (Studim projektim objekte industriale dhe civile)*
- BS PAS 99: 2012 (Studim projektim objekte industriale dhe civile)*
- UNI EN ISO 3834-2 : 2006 (Studim projektim objekte industriale dhe civile konstruksione metalike dhe saldimet)*

Në rastet e bashkimit të konsulentëve, kriteret e veçanta të kualifikimit plotësohen bashkarisht nga i gjithë bashkimi.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 11

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilesinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.
- Personi/at në cilësinë e *anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik*, si më poshtë:

_____ etj.

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP⁵.

- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- Operatori ekonomik _____ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

⁵ Autorizoj Autoritetin Kontraktor të bëjë verifikimet përkatëse të gjendjes gjyqësore të personave të deklaruar në këtë Deklaratë

Dokumentat standarte të tenderit

- Operatori ekonomik _____ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

Shtojca 11/1

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

**DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE
LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS**

Deklaratë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____, **deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:**

- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 12

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: Siç parashikohet ne **Termat e References**

Shtojca 13

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

<input type="checkbox"/> Shërbim: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01	_____	_____
02	_____	_____
03	_____	_____
...	_____	_____

Shtojca 14

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: “Studim projektim për furnizimin me ujë të fshatrave Radësh, Vërzhezhë, Orizaj, Munushtir, Vëndreshë e dytë, Storrë, Potom, Bashkia Skrapar“.

Afatet e ekzekutimit: 3 (tre) muaj nga lidhja e kontrates se shërbimit

Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

TERMAT E REFERENCËS

DETYRË PROJEKTIMI

Për objektin:

“Studim projektim për furnizimin me ujë të fshatrave Radësh, Vërzhezhë, Orizaj, Munushtir, Vëndreshë e dytë, Storrë, Grepckë, Blezëncë, Potom, Bashkia Skrapar“

Në përputhje me legjislacionin Shqiptar, Bashkia Skrapar kërkon të realizojë: Studimin dhe hartimin e projekteve të zbatimit për objektin **“Studim projektim për furnizimin me ujë të fshatrave Radësh, Vërzhezhë, Orizaj, Munushtir, Vëndreshë e dytë, Storrë, Grepckë, Blezëncë, Potom, Bashkia Skrapar“**, nëpërmjet të cilit do të realizohet furnizimi me ujë për 24 orë i 9 fshatrave të bashkisë Skrapar.

I. PERSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

1) Fshati Radesh

Vendndodhja: Njësia Administrative Qendër, Bashkia Skrapar

Vendburimi i marrjes së ujit: prane rezervuarit të fshatit Mollas .

Ky fshat ka aktualisht 320 banorë dhe 84 familje. Vlen të theksohet se afërsia me qytetin ka bërë që një numër banorësh të larguar në mesin e viteve '90, të kthehen dhe të investojnë në rikonstruksionin apo ndërtimin nga e para të shtëpive të tyre. Në vitin 1999, është bërë një investim i pjesshëm në ujësjellësin e këtij fshati, megjithatë sot ai paraqitet në gjendje shumë të amortizuar. Fshati furnizohet me ujë, me rrjedhje të lirë, nga dy burime të cilat ndodhen 2,5km larg nga fshati.

2) Fshati Verzezhë

Vendndodhja: Njësia Administrative Qendër, Bashkia Skrapar

Vendburimi i marrjes së ujit: Ne krye të fshatit në lartësinë rreth 900 m mbi nivelin e detit.

Ky fshat ka aktualisht 385 banorë dhe 76 familje. Duhet theksuar se në periudha të ndryshme të vitit ky numër rritet ndjeshëm. Fshati ndodhet 5km nga qyteti i Çorovodës, lidhet me rrugë të asfaltuar dhe zhvillon aktivitet të konsiderueshëm në fushën e agrikulturës. Ujësjellësi i këtij fshati është ndërtuar në vitin 1995. Aktualisht ai paraqitet në gjendje tejet të amortizuar. Një pjesë e fshatit furnizohet me ujë nga një degë e ujësjellësit të ndërtuar në vitet 1970. Fshati furnizohet me ujë, me rrjedhje të lirë, nga tre burime: dy nga të cilët ndodhen 3km larg nga fshati dhe i treti rreth 1.5km.

3) Fshati Munushtir

Vendndodhja: Njësia Administrative Qendër, Bashkia Skrapar

Vendburimi i marrjes së ujit: Ne krye te fshatit ne largesine 1.5 km.

Ky fshat ka aktualisht 235 banorë dhe afërsisht 60 familje. Fshati ndodhet në hyrje të qyteti të Çorovodës dhe ka një aktivitet shumë të konsiderueshëm në fushën bujqësisë dhe është ndër furnizuesit kryesorë të qytetit. Ujësjiellësi i këtij fshati është ndërtuar në fillimin e viteve 1970. Aktualisht është në gjendje tejet të amortizuar. Fshati furnizohet me ujë nga dy burime, me rrjedhje të lirë, të ndodhura në krye të fshatit në largësi 1.5km secili.

4) Fshati Orizaj

Vendndodhja: Njësia Administrative Qendër, Bashkia Skrapar

Vendburimi i marrjes së ujit: Burimi i Guakut ne largesine 6 km nga fshati

Ky fshat ka aktualisht 180 banorë dhe 45 familje. Fshati ndodhet në hyrje të qytetit të Çorovodës, në të dy krahët e rrugës automobilistike, dhe ka një aktivitet shumë të konsiderueshëm në fushën e bujqësisë. Deri në fund të viteve 1990, ky fshat është furnizuar me ujë nga burimi i Guakut, duke qenë pjesë e zonës industriale të qytetit. Në këtë periudhë, me ndalimin e aktivitetit industrial është dëmtuar dhe nxjerrë jashtë përdorimit edhe rrjeti kryesor i furnizimit me ujë nga burimi i sipër përmendur. Në fillim të viteve 2000, në këtë fshat është realizuar një investim, sipas të cilit ky fshat do të furnizohej me ujë nga burimet e fshatit Storrë. Megjithatë, për shkak të konflikteve mes dy fshatrave, ky investim nuk u bë asnjëherë efektiv. Ai u dëmtuar duke filluar që nga vepra e marrjes dhe rrjeti kryesor dhe sot nuk ekziston më. **Aktualisht ky fshat nuk ka ujësjiellës.** Çdo familje furnizohet, sipas mundësive, privatisht. Në sezonin e verës gjendja rëndohet së tepërmi dhe banorët detyrohen të vijnë në qytet për t'u furnizuar me ujë.

5) Fshati Strove

Vendndodhja: Njësia Administrative Qendër, Bashkia Skrapar

Vendburimi i marrjes së ujit: 3 burime te ndodhura ne krye te fshatit ne largesi 1.5 km

Ky fshat ka aktualisht 225 banorë dhe 65 familje. Fshati ndodhet rreth 5km larg nga qyteti i Çorovodës (3km larg nga rruga nacionale) dhe ka një aktivitet shumë të konsiderueshëm në fushën bujqësisë. Ujësjiellësi është ndërtuar në vitin 1974 dhe i është nënshtruar rikonstruksionit të pjesshëm në vitin 2000. Aktualisht, ujësjiellësi është në gjendje të amortizuar dhe ka nevojë për ndërhyrje tërësore. Ky fshat furnizohet, me rrjedhje të lirë, nga tre burime të ndodhura në krye të fshatit në largësi 1.5km nga fshati, duke bërë që rrjeti kryesor të ketë gjatësi prej 4.6km

6) Fshati Grepckë

Vendndodhja: Njësia Administrative Qendër, Bashkia Skrapar

Vendburimi i marrjes së ujit: 1 burim te ndodhur ne krye te fshatit ne largesi 2.5 km nga fshati.

Ky fshat ka aktualisht rreth 120 banorë dhe 40 familje. Fshati ndodhet rreth 6km larg nga qyteti i Çorovodës në krahun e majtë të lumit Osum (në krah të kanionit) dhe ka një aktivitet shumë të konsiderueshëm në fushën bujqësisë. Ujësjiellësi nuk ka qënë ndërtuar asnjëherë i plotë. Nga një

burim rreth 2.5km larg fshatit furnizohet depoja e vetme e fshatit nga të cilat marin ujë vetëm 10 familje. Pjesa tjetër e fshatit nuk ka fare ujësjellës dhe familjet kanë gjetur zgjidhje individuale me burime të vogla apo puse.

7) Fshati Blezënckë

Vendndodhja: Njësia Administrative Çepan, Bashkia Skrapar

Vendburimi i marrjes së ujit: 1 burim te ndodhur ne krye te fshatit ne largesi 2.5 km nga fshati.

Ky fshat ka aktualisht rreth 200 banorë dhe 50 familje. Fshati ndodhet rreth 10km larg nga qyteti i Çorovodës në krahun e majtë të lumit Osum (në krah të kanionit) dhe ka një aktivitet shumë të konsiderueshëm në fushën bujqësisë. Ujësjellësi është ndërtuar në vitin 1975 dhe i është nënshtruar rikonstruksionit të pjesshëm në vitin 1998. Aktualisht, ujësjellësi është në gjendje të amortizuar dhe ka nevojë për ndërhyrje tërësore. Ky fshat furnizohet, me rrjedhje të lirë, nga dy depo dhe dy burime të ndodhura në krye të fshatit në largësi 1.5km nga fshati, duke bërë që rrjeti kryesor të ketë gjatësi prej 3km.

8) Fshati Potom

Vendndodhja: Njësia Administrative Potom, Bashkia Skrapar

Vendburimi i marrjes së ujit: tetë burimet aktuale në largësi nga 10m deri në 1500m nga fshati

Ky fshat ka aktualisht 365 banorë dhe afërsisht 90 familje. Për shkak të përhapjes së gjerë gjeografike, ky fshat furnizohet nga 8 burime, të gjitha me rrjedhje të lirë. Ujësjellësi i këtij fshati, ose më mirë të themi i pjesëve përbërëse të tij, është ndërtuar duke filluar nga viti 1980 deri 1999. Aktualisht, rrjeti i furnizimit më ujë për lagjet e këtij fshati është i amortizuar.

9) Fshati Vendreshe e Dyte

Vendburimi i marrjes së ujit: Burim 1 km larg fshatit

Vendndodhja: Njësia Administrative Vëndreshë, Bashkia Skrapar

Ky fshat ka aktualisht rreth 90 banorë rezidentë të përhershëm dhe 40 familje. Ujësjellësi i këtij fshati është ndërtuar në mesin e viteve 1970. Aktualisht ai është në gjendje tejet të amortizuar. Furnizimi bëhet me rrjedhje të lirë nga një burim rreth 1km larg nga fshati.

II. QELLIMI

Nëpërmjet kësaj detyre projektimi, synohet të realizohen projektet e furnizimit me ujë për fshatrat **Radësh, Vërzhezhë, Orizaj, Munushtir, Vëndreshë e dytë, Storrë, Grepckë, Blezënckë, Potom, Bashkia Skrapar** duke marrë në konsideratë gjendjen egzistuese.

Perspektiva llogaritëse do të merret për 25 vjet dhe furnizimi me ujë do të jetë pa ndërprerje.

Rritja e popullsisë në vite do të merret nga 1% ku përfshihet rritja natyrore dhe levizja demografike e popullatës.

Norma e konsumit ditor do te merret **bazuar ne vendimin e Keshillit te Ministrave Nr 722 date 19.11.1998 120 l/dite per banore** duke shtuar dhe konsumin komercial dhe social prej 20-30% e cila shkon ne total **150 l/dite per banore**.

III. FAZAT E SHËRBIMEVE

Për të realizuar me sukses qëllimin e kësaj detyre projektimi, konsulentit i kërkohet të kalojë në këto faza shërbimesh:

– Konsulenti do të marrë të gjithë informacionin e mundshëm nga kjo detyrë projektimi si dhe çdo informacion të marrë nga Autoriteti Kontraktor apo burime të tjera, vrojtime dhe matje në terren për të përcaktuar alternativa zgjidhjesh të ndryshme, por gjithmonë duke përzgjedhur variantin më të përshtatshëm nga ana teknike dhe ekonomike.

– Do të hartohet relacioni hidrologjik i burimeve egzistues në secilin fshat.

– Do të analizohet gjendja e ujësjellësave egzistues, përfshirë veprën e marrjes, depo, apo stacione pompimi në rastet e ujësjellësave me ngritje mekanike, linjat e dërgimit dhe rrjetin e shpërndarjes deri te konsumatorët dhe do të përcaktohet në çdo rast niveli i ndërhyrjes, lloji i materialeve kryesore dhe alternativat përkatëse.

– Do të llogaritet nevoja e konsumatorëve për sasinë e ujit pa ndërprerje për 25 vjet.

– Do të realizohen llogaritje paraparke të kostove dhe shpenzimeve për secilin variant të propozuar dhe do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor për përzgjedhje dhe miratim.

– Me miratimin nga Autoriteti Kontraktor, do të realizohen llogaritjet përfundimtare të kostove dhe shpenzimeve, sipas variantit të miratuar, për secilin ujësjellës, duke përfshirë projektet dhe preventivat për: veprën e marrjes, depo, apo stacionet pompimit, linjat e dërgimit dhe rrjetin e shpërndarjes deri te konsumatorët, përfshirë matësat, siç është rënë dakort për çdo rast.

– Do të bëhet studimi i plotë gjologo-inxhinierik i aksit ku do të kalojë linja e dërgimit dhe elementëve të tjerë të sistemit të furnizimit me ujë të qendrave të banuara të sipërpërmendura.

– Do të hartohet raporti topografik përfundimtar, i cili nevojitet për projektin e zbatimit . me vendndodhjet e sakta të pikave kryesore dhe repërve, të cilët duhet të jenë të fiksuara. Të gjitha kuotat duhet të jenë absolute.

– Do të llogariten kostot e ndërhyrjeve në infrastruktura rrugore, për realizimin e rrugëve të aksesit dhe të shërbimit për realizimin e veprave të projektit, duke evidentuar edhe shpronësimet e mundshme të pronës private, nëse rezulton e nevojshme.

– Në rastet kur do të kërkohet nga Autoriteti Kontraktor, konsulenti do të marr përsipër përgatitjen e të gjithë dokumentacionit për leje ndërtimi si dhe aplikimin për leje në sitemin e-lej.

III. AFATET PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT

Afati për hartimin e Projekt zbatimit dhe të preventivit përfundimtar do të jetë jo më vonë se **3 (tre) muaj** nga data e lidhjes së kontratës.

IV. REALIZIMI I PROJEKTIT

1. Standartet

1.1.Standarte në Projektim

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standartet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi.

Është përgjegjësi e Projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standarteve dhe normave përkatëse.

Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standareve të reja, për përafrimin me normat e BE-se, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim. Rekomandimet duhet të përmbajnë elemente të fizibilitetit dhe realizueshmërisë me praktikën shqiptare dhe limitimet për financimin e veprës.

1.2.Standarte në paraqitjen e dokumentacionit teknik

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, Projektuesi do të përdorë programet e kërkuara kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, më të avancuara të fushës. Në hartimin, paraqitjen dhe miratimin e dokumentacionit teknik të projektit të kihet parasysh dhe të respektohen të gjitha kërkesat dokumentare dhe të paraqitjes që parashikon Ligji “Për Planifikimin e Territorit”, dhe aktet e tjera nënligjore.

Me anën e këtij raporti teknik të sqarohen investigimet e bëra nga projektuesi për gjendjen egzistuese, kushtet teknike dhe kriteret e projektimit, llogaritjet përkatëse për mënyrën e furnizimit me ujë. Gjithashtu të jepen përshkrime për fazat e ndërhyrjes dhe rehabilitimit të sistemit, specifikimet teknike për materialet si dhe proceset e punimeve që do të kryhen, vizatimet e nënobjekteve, që do të ndërtohen (planimetri, profila, prerje, hollësi ndërtimore, detaje teknike etj), si dhe volumet kryesore të punimeve dhe materialeve, makinerive e pajisjeve që duhen për kryerjen e kësaj ndërhyrjeje për ndërtimin e këtyre ujësjellësave dhe për zgjidhjen përfundimisht të problemit të furnizimit me ujë për sot dhe në perspektive.

1.3.Projekti i zbatimi

Projekti i zbatimit për **furnizimin me ujë të fshatrave Radësh, Vërzhezhë, Orizaj, Munushtir, Vëndreshë e dytë, Storrë, Grepçkë, Blezënckë, Potom, Bashkia Skrapar** duhet të përmbajë:

- Raportin Teknik, i cili duhet të përmbajë përveç të dhenave të tjera lidhur me gjendjen ekzistuese dhe përzgjedhjen e variantit më të përshtatshëm për zgjidhjen e investimit duhet të përmbajë edhe llogaritjet statike të strukturave të ndryshme, llogaritjet hidraulike për linjat e tubacioneve dhe veprën e marrjes së furnizimit me ujë si dhe llogaritje të tjera të objekteve të ndryshme.
- Koreografinë e zonës në shkallë 1:10000 – 1:25000.
- Hartimi i relievit topografik të zonës ku do të ndërhyet (kordinata lokale, kordinata absolute).
- Planvendosjen e objektit si dhe të objekteve të veçanta të përfshira në këtë projekt.
- Projektin e tubacionit të dërgimit, planimetri, prerje gjatësore e tërthore etj.
- Projektin e ndërtimit të veprës së marrjes së ujit, planimetri, prerje.
- Projektin e ndërtimit të godinës pranë veprës së marrjes, e cila do të përbëhet nga ambjenti i komandimit të pompave, zyrat, abmjente të thera ndihmëse për puntorët etj., planimetri, prerje detaje teknike.
- Në rast se gjatë studimit të projektit lind nevoja e ndërtimit të depove duhet të hartohet projekti i saj së bashku me elementët e tjerë të depos si planimetri, prerje, dhoma e rojes etj.
- Profili gjatësor dhe tërthor i çdo linje.
- Profil tërthor tip.
- Hollësi dhe detaje teknike të ndërtimit të veprës.
- Specifikimet Teknike për zërat e punimeve që do të kryhen
- Grafikon e punimeve
- Preventivin e punimeve shoqëruar me analizat e çmimeve për zërat që nuk janë në manualin e çmimeve të miratuar sipas Vendimit Nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.
- Raportin e vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM).
- Plan organizimin e punimeve si dhe grafikun e kohëzgjatjes së tyre.

- Marrjen e masave të sigurimit Teknik si të punëtorëve ashtu edhe të publikut.
- Raporti gjeologo-inxhinierik

1.4.Paraqitja e vizatimeve

Vizatimet e projektit duhet të përmbajnë minimum fletët si më poshtë:

- Koreografia e përgjithshme e zonës në format jo më të vogël se A3
- Planimetria e relievit të sheshit të ndërtimit të objektit në formate jo më të vogël se A3
- Profilat gjatësor të rrugës të jenë të projektuar në formate jo më të vogël se A3
- Profilat tërthor në format jo më të vogël se A3
- Planimetritë e çdo objekti në formate jo më të vogla se A3
- Planorganizimi i punimeve në format jo më të vogël se A3
- Planvendosjet e objekteve në formate jo më të vogla se A3
- Hollësi dhe detaje të tjera teknike në formate jo më të vogla se A3
- Në format A4 relacioni teknik, raporti gjeologo-inxhinierik, llogaritjet, specifikimet teknike, grafiku i punimeve dhe preventivi me dhe pa çmime, Raportin e vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM), Marrjen e masave të sigurimit Teknik si të punëtorëve ashtu edhe të publikut.

2. Rekomandime për projektuesin

- 2.1. Projektuesi duhet të përdorë dhe të rishikojë të gjithë informacionin egzistues lidhur me objektin.
- 2.2. Projektuesi duhet të përdorë studimet dhe të dhënat paraprake që disponohen nga Institucionet shtetërore si seksioni i Urbanistikës, Arshiva dhe nga Kadastra e Bashkisë Skrapar .
- 2.3. Cilësia e studimit duhet të jetë e tillë që të arrihet në standartin e kërkuar.

V. Dorëzimi I Projektit

V.1. I gjithë dokumentacioni do të paraqitet në 3 (tre) kopje origjinale në format PDF, si dhe në version të dixhitalizuar në 2 (dy) CD, ku një CD do të përmbajë punimet në DËG, Office Ëord-Excel, dhe një CD do të përmbajë të gjithë dokumentacionin në format PDF.

V.2 I gjithë dokumentacioni që përmbajnë CD sipas formatit PDF do të jenë të firmosura elektronikisht sipas kërkesave për pajisje me leje ndërtimi të përcaktuara në bazë të ligjit nr. 107/2014“Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, si dhe VKM-së nr. 408 datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar me VKM Nr.271, datë 6.4.2016.

Shtojca 16

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR⁶

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u skualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< Emri >

⁶ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Shtojca 17

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data_____]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

* * *

Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

Etj.

* * *

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në fazat e tjera të procedurës së sipërcituar këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Dokumentat standarte të tenderit

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*
Vlera _____
(me numra dhe fjalë)
Etj.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*
2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*
Etj.

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri, Nipti dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur nga ana juaj dhe e vlerësuar me _____ pikë, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) siç parashikohet në nenin 49 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 18

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____

2. _____

3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

